



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 15, datë 23.01.2020**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERA HYDRO” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STRORI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1, gërma “a”; nenit 10, pika 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”; si dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 19/2 Prot., datë 18.01.2020 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes lidhur me “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ERA HYDRO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Strori” me kapacitet të instaluar 2000 kw”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 17 Prot., datë 07.01.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Strori”.
- Shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k., është njohur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si Mbajtëse e Miratimit dhe ka nënshkruar me të kontratën nr. 16 Rep dhe nr. 12/3 Kol, datë 05.01.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit Strori me kapacitet prodhues 2 MW, në përroin e Holtës dhe Seltës, degë e Lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”. Kjo kontratë është lidhur midis Mbajtësit të Miratimit shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k. dhe MIE, me një afat 49 vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritje.
- Sipas Programit të punimeve të kësaj kontrate, koncesionari merr përsipër:
  - të fillojë punimet në zbatim të projektit brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me lejen e fillimit të punimeve të ndërtimit;
  - të vërë në punë hidrocentralin brenda 21 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç parashikuar në Aneksin 2, bashkëlidhur kësaj kontrate, grafiku i zbatimit të punimeve;

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, dokumentacioni i depozituar nga shoqëria “ERA HYDRO” shpk, në aplikimin për pajisjen me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, rezulton si më poshtë vijon:
  - Formati i aplikimit (Neni 9, pika 1 gërmat “a”; “b”; “c”) është plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka përcjellë asnjë informacion në lidhje me të dhënat për aplikuesin (9.1 c);
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht;
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, ( neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar pjesërisht;  
Dokumentacioni teknik për HEC, ( neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2 ; pika 4.1.3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4 , gërmat “a”, “b”, “c” , “d”, “e”; pika 4.1.5, gërmat “a”, “b”, “c” ) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria në këtë aplikim është kryesisht i plotësuar me përjashtim të dokumentacionit si më poshtë i cili rezulton i munguar ose jo në formën e kërkuar nga rregullorja:
  - Neni 9, pika 1: gërma “c” (të dhëna për aplikuesin) nuk është sjellë në formën e kërkuar nga rregullorja.
  - Neni 9, pika 2: gërma “c” (vërtetimi i regjistrimit nga QKB) nuk është sjellë në formën e kërkuar nga rregullorja;
  - Neni 9, pika 2 gërma “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria) Plotësuar pjesërisht. Mungojnë Vërtetimet e Prokurorisë, dhe duke qenë se adresa e shoqërisë rezulton të jete në qarkun e Elbasanit, do t’i kërkohej të përcjellë në ERE Vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë nga ky rreth gjyqesor, si për vetë shoqërinë dhe për përfaqesuesit e saj;
  - Neni 9, pika 2, gërma “e” (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohej licenca), e pa plotësuar;
  - Neni 9, pika 3: gërma “b” (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit) plotësuar pjesërisht;
  - Neni 9, pika 3, gërma “d” (vërtetimin e pagesës së aplikimit në llogari të ERE-s) plotësuar pjesërisht;
  - Neni 9, pika 4.1.1 Të dhëna specifike për HEC, janë plotësuar pjesërisht;
  - Neni 9, pika 4.1.2 Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin. Plotësuar pjesërisht;
  - **Gërma “c” Leje mjedisore. Plotësuar.**

Shoqëria ka depozituar në ERE me shkresën nr. 940 Prot., datë 18.04.2017 të Ministrisë së Mjedisit, VNM Paraprake me nr. vendimi 16 dhe nr. Identifikimi 258, e lëshuar për “ERA

HYDRO” sh.p.k, për ndërtimin dhe operimin e “HEC Strori” me kapacitet të instaluar 1972 kW. Sa i përket vlefshmërisë së kësaj leje, në përmbajtjen e saj citohet se: *“Ky vendim është i vlefshëm pasi veprimtaria licencohet nga institucionet përkatëse. Mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe dy vjeçare sjell për pasojë pavlefshmërinë e vendimit për ushtrimin e këtij aktiviteti.”*

Për dokumentacionin e munguar apo të sjellë jo në formën e kërkuar nga rregullorja, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve të përcaktuara në nenin 10 dhe 11, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Energjisë Elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ERA HYDRO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Strori” me kapacitet të instaluar 2000 kW, për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**